

Referat Informues

Konferenca në Wilton Park, 30 Janar – 1 Shkurt 2004

E ARDHME POST-INDUSTRIALE?

EKONOMIA DHE SHOQËRIA NË MITROVICË DHE ZVEÇAN

Ky referat jep një pamje të përgjithshme që ka dalë nga një punë kërkimore 18 mujashe nga ESI mbi ekonominë dhe shoqërinë në Mitrovicë dhe rrethinë. Materiali është paraqitur dhe mund të përdoret si burim informimi gjatë takimit që fillon në Wilton Park më 30 Janar. Ne i kemi plotësuar të dhënat e kufizuara zyrtare për Mitrovicën me kërkimet tona të kohëve të fundit, dhe shumë nga përfundimet tona sfidojnë pamjen zyrtare dhe perceptimin e përgjithshëm. Ne i mirëpresim komentet dhe kontributin e pjesëmarrësve në Wilton Park.¹

1. POPULLSIA

Studimi ynë tregon se si Mitrovica Veriore ashtu edhe ajo Jugore kanë përjetuar një rënie të vazhdueshme të numrit të popullsisë gjatë dekadës së fundit.

Regjistrimi i fundit i plotë i popullsisë në Kosovë u krye më 1981. Asokohe, komuna e Mitrovicës përbëhej nga tri njësi që sot janë komuna më vete: Mitrovica, Zveçani dhe Zubin Potoku. Ajo kishte një popullsi 105,322 banorë. Dy të tretat ishin shqiptarë, çereku serbë e malazezë.²

Tabela 1: Regjistrimi më 1981 në Mitrovicë
(përfshirë Zveçanin dhe Zubin Potokun)

Shqiptarët	66,528
Serbët e Malazezët	27,929
Boshnjakët, Romët, Të tjerët	10,865
Totali	105,322

Shumica e shqiptarëve të Kosovës nuk morën pjesë në regjistrimin e vitit 1991. Regjistruesit e përlllogaritën numrin e shqiptarëve mbi bazën e ritmeve shumë të larta të rritjes së popullsisë. Në Mitrovicë, ata llogaritën se popullsia shqiptare ishte shtuar 30.5% gjatë dekadës së fundit, me një rritje vjetore 2.7%. Kjo shifër duket shumë e lartë. Studiuesit kanë vlerësuar se ritmet mesatare të shtimit të popullsisë në radhët e shqiptarëve të Kosovës në vitet '80-të kanë qenë

¹ Studimi u krye nga ESI në kuadrin e Njësisë për Nxjerrjen e Mësimeve dhe Analizës të Shyllës së BE në UNMIK, projekt i përbashkët i Shtyllës dhe ESI-t. Për më shumë informacion, shih www.esiweb.org.

² Më 1987, Zubin Potoku (me 90% popullsi serbe) u bë komunë e pavarur, pasuar nga Zveçani më 1990.

2.54%.³ Regjistrimi i 1991-it tregoi edhe një rënie të madhe të numrit të serbëve dhe malazezëve në Mitrovicë gjatë viteve '80-të; nga 13,544 në 10,698 (një rënie prej 21%) Që prej vitit 1991 nuk ka pasur regjistrim të popullsisë. Vitet '90-të sollën emigrim masiv të shqiptarëve të Kosovës, çka arriti kulmin gjatë konfliktit më 1999 që shkaktoi jo thjesht valë massive refugjatësh, por edhe lëvizje të popullsisë mes zonave rurale dhe urbane si dhe mes veriut dhe jugut të Kosovës. Shumë serbë u zhvendosën në Mitrovicën Veriore nga pjesë të tjera të Kosovës.

Tabela 2: Shifrat e regjistrimit më 1981 dhe 1991 në Zveçan dhe Mitrovicë
Mbi bazën e kufijve ekzistues

	Zveçan		Mitrovicë	
	1981	1991	1981	1991
Shqiptarë	1,043	1,934	63,464	82,837
Serbë e Malazezë	8,409	7,882	13,544	10,698
Boshnjakë, Romë, Të tjerë	210	214	10,540	11,350
Totali	9,662	10,030	87,548	104,885

Vlerësimi ynë për popullsinë rezidentë në Mitrovicën Veriore dhe Jugore sot (pa llogaritur shtetasit e huaj apo rreth 2,000 studentë në Mitrovicën Veriore) është 82,264. Kjo shifër është shumë më e ulët se vlerësimi në regjistrimin e 1991-it, dhe më i ulët se shifra e regjistrimit më 1981.

Tabela 3: Popullsia rezidente më 2003 sipas vlerësimeve të ESI-t

	Zveçan	Mitrovicë Jug	Mitrovicë Veri
	Shqiptarë	470	65,012
Serbë e Malazezë	7,016	300	13,402
Boshnjakë, Romë, Të tjerë	380	600	850
Totali	7,866	65,912	16,352

Zyrtarët në Mitrovicë përdorin shifrën deri në 130,000 banorë në Mitrovicën Veriore dhe Jugore në dokumentet e tyre. Përse shifrat që japim ne janë ndryshe?

Ne nisemi nga njëri prej burimeve të pakta të besueshme të të dhënave administrative që mund të gjenden sot në Kosovë: shifrat e regjistrimit në shkollat fillore. Dihet që shumica e nxënësve shkojnë në shkolla pranë shtëpisë, prandaj ka një lidhje të fortë mes numrit të nxënësve në shkollat fillore dhe popullsisë rezidente. Në të gjithë Kosovën, sondazhet e ndryshme kanë treguar se përqindja e popullsisë nën 16 vjeç ka qenë vazhdimisht rreth 33% (kjo përqindje është më e ulët ndër serbët dhe në zonat urbane që kanë ritme më të ulta rritjeje, dhe është më e lartë në zonat rurale). Ne përdorim regjistrat e shkollave fillore për të nxjerrë popullsinë nën 16 vjeç, dhe prej andej llogarisim popullsinë rezidente. Shifrat tona tregojnë se si komuniteti shqiptar ashtu edhe ai serb kanë rënë ndjeshëm gjatë dekadës së fundit.

³ Karl Kaser, *Familie und Verwandtschaft auf dem Balkan* (Vienë, 1995), faqe 139.

Tabela 4: Nxënësit në fillore dhe popullsia (2003)⁴

Vendi	Nxënës në fillore	Nën 16 vjeç	Vlerësimi në % të popullsisë	Vlerësim I numrit të popullsisë
Mitrovica Jugore	11,810	22,144	32.8	67,512
Mitrovica Veriore	1,940	3,638	25.0	14,552
Zveçani	986	1,849	25.0	7,396

Përfundimi ynë se ka pasur një ulje të konsiderueshme të numrit të popullsisë në dy dekadat e fundit del nga rënia korresponduese e numrit të regjistrimeve në shkolla. Më 1981, në Mitrovicë, Zveçan dhe Zubin Potok kishte 18,781 nxënës në shkollat fillore, numër që u rrit në 19,578 më 1988. Sot, ky numër ka rënë me 20%, në 15,791.

2. TË ARDHURAT MONETARE NË MITROVICËN JUGORE

Për të dhënë një pasqyrë të gjendjes ekonomiko-shoqësore të Mitrovicës së sotme, ne vendosëm të dilnim me shifra për burimet kryesore të të ardhurave në të dy komunitetet. Si jetojnë sot 66,000 banorët e Mitrovicës Jugore?

Sektori i ndërmarrjeve shoqërore (SOE) – dikur shtylla kurrizore e ekonomisë locale – thuajse është zhdukur si burim të ardhurash. Pjesët e kompleksit të Trepçes në Jug punësonin mbi 7,000 vetë më 1989. Tashmë ato thuajse e kanë ndërprerë plotësisht aktivitetin; ka vetëm 779 vende pune në mirëmbajtje, dhe që financohen d.p.d. nga buxheti i Kosovës.⁵ Fuqia e dikurshme punëtore e minierës po mplaket; sipas një vlerësimi të IOM-it më 2002, mosha mesatare e minatorëve është 49 vjeç. Ndryshe nga kolegët e tyre të veriut, ata që nuk kanë një pozicion të subvencionuar, nuk marrin ndihma nga UNMIK.

Tabela 5: Pjesët e mbetura të Trepçes në Jug të Mitrovicës, 2003

Njësia	Punonjës	
	1989/90	2003
Stari Terg/Stan Terg (miniera dhe pasurimi)	3,061	528
Uzina e Baterive	1,379	50
Metalurgjia e Zinkut	1,146	87
Industria Kimike	1,094	42
Fabrika e Pajisjeve	380	31
Menaxhimi dhe Siguria		41
Totali	7,060	779

Ndërmarrjet e mbetura shoqërore nuk janë në punë, përgjithësisht. Punëdhënësja më e madhe është kompania tregtare “Lux”, e cila e ka ndërprerë aktivitetin, ndonëse vazhdon të paguajë rreth 300 punëtorë nga të ardhurat e siguruar nga dhënia me qera e ambjenteve. Punëdhësi i dytë më i madh është “IMB”-ja, një kompleks i madh furre me 160 punëtorë. “Kosovatrans”, kompania e autobusëve të qytetit (simotra e “Kosmet prevoz” në Veri) zyrtarisht punëson 300 vetë, por është në gjendje të paguajë vetëm gjysmën e punëtorëve. Hotel “Adriatik”, ku ka

⁴ Numri i nxënësve në Mitrovicën Jugore përfshin fëmijët e 2,100 shqiptarëve që jetojnë në Veri. Shifrat e Veriut përfshijnë të gjithë fëmijët që mësojnë në serbisht (Malazetë, Boshnjakët, Goranët dhe Romët).

⁵ Burimi: Menaxhmenti i Trepçes Jug

qëndruar për një kohë të gjatë KFOR-i francez, nuk është i hapur për vizitorët. Të gjitha së bashku, përveç punëve në sektorin e mirëmbajtjes në Trepçe që financohen nga buxheti, zor se bëhen 1,000 punëtorë që sigurojnë të ardhura nga puna në sektorin e ndërmarrjeve shoqërore.

Shkurt, qendra e dikurshme industriale e Mitrovicës Jugore është shndërruar në një bashkësi post-industriale. Kur futesh në sallën e mbledhjeve në “Qendrën për Zhvillimin e Biznesit në Mitrovicë”, që ndodhet në sheshin qendror përkarshi qendrës kryesore tregtare, në një kënd me xhama reklamohen produkte lokale. Janë mallrat e 13 prodhuesve: dyer e dritare, mobilje për fëmijë, detergjentë e shampoo, supa të paketuara, shkurës, qese najloni, rroba të qepura me dorë dhe prodhime lëkure. Së bashku, këto 13 firma kanë punësuar më pak se 100 vetë. Në të gjithë Mitrovicën Jugore, më pak se 350 vetë janë të regjistruar si punëtorë në industri,⁶ dhe shifra e saktë ndoshta është edhe më e ulët. Të mbijetosh si prodhues privat është e vështirë. P.sh., makinerisë “Irtex” për prodhimin e produkteve të najlonit i duhen tri orë që të nxehet përpara se të fillojë nga puna. Ndërprerjet e shpeshta të rrymës në dimër, shpesh me sistemin 4 orë po e 4 orë jo, e bëjnë të pamundur prodhimin me rendiment.⁷

Pas vitit 1999, i vetmi investim i rëndësishëm në Mitrovicën Jugore ka qenë në banesa. Ndërsa ndërtimi ishte një sektor në rritje menjëherë pas luftës, me fondet e ndihmës ndërkombëtare për rindërtim dhe të hollat e dërguara nga familjarët jashtë vendit, kjo tendencë duket qartë se po ndryshon kah. Sipas të dhënave të komunës, deri në mars 2003, 40 kompani ndërtimi kishin ndërprerë aktivitetin, duke lënë 304 punëtorë pa punë.⁸ Pjesa tjetër e sektorit privat përbëhet kryesisht nga dyqane, taksi dhe pak restorante, ku shpesh shkojnë të huajt.

Një studim i UNMIK-ut i vitit 2001 arriti në përfundimin se 72.5% e mikro-ndërmarrjeve janë mbi baza familjare. Afro gjysma e ndërmarrjeve kategorizohen se janë në “nivelin e mbijetesës”, që do të thotë se “luhatjet më të vogla në treg mund të shkaktojnë mbyllje të menjëhershme të tyre”. Sipas këtij studimi, në Mitrovicë 30.8% e mikro-ndërmarrjeve funksionojnë pa ambiente (objekte), 38.5% nuk kanë rrymë dhe 46.2% nuk kanë furnizim me ujë.⁹

Në total, vlerësimi më optimist është që në sektorin privat janë angazhuar rreth 5,400 vetë, duke gjeneruar përafërsisht të ardhura në të holla që llogariten në një milion euro në muaj si rroga të sektorit privat.

Duke pasur parasysh rënien e sektorit shoqëror dhe ndërmarrjeve të vogla private, rëndësia e sektorit publik është rritur edhe më shumë. Mbi 4,000 vetë janë punësuar në shkolla, institucione shëndetësore, polici, administratë dhe – siç e kemi përmendur më lart – në sektorin e subvencionuar të Trepçes.

Krahas të ardhurave nga rroga, në Mitrovicë ka 4,310 pensionistë shqipfolës dhe 3,780 vetë që marrin asistencë. Asistenca është shumë e ulët. Pensionet janë 38 euro në muaj për çdo person mbi 65 vjeç, pavarësisht nga puna që ka pasur. Asistenca sociale luhatet nga 34-62

⁶ Burimi: Komuna e Mitrovicës; Përlllogaritjet e ESI-t.

⁷ Qendra për Zhvillimin e Biznesit në Mitrovicë.

⁸ Burimi: Komuna e Mitrovicës, Departamenti i Ekonomisë

⁹ UNMIK – Departamenti Administrativ i Punës dhe Punësimit, *Mitrovicë. Ura drejt së Ardhmes. Mikro Ndërmarrjet. Situatat dhe Perspektiva*, Shkurt 2001, pp. 4, 7, 10, 12, 29, 21. (Të dhënat bazohen në studimin e 305 ndërmarrjeve në komunat Mitrovicë, Vushtrri/Vucitrn dhe Skënderaj/Srbica).

euro në muaj, në varësi të numrit të pjesëtarëve në familje. Shifra 8,090 vetë që marrin asistencë ose pensione është thujse e barabartë me numrin e të punësuarve.

Në se Mitrovica jugore ka një popullsi prej 66,000 banorësh, të ardhurat mujore në të holla për frymë të popullsisë janë 38 euro në muaj (një numër më i lartë i popullsisë do të thotë që kjo shifër të jetë edhe më e vogël). Ka shumë pak gjasa që numri i vendeve të punës apo niveli i rrogave të rriten në të ardhmen e afërt. Në fakt, si punët me ndërkombëtarët ashtu edhe sektori privat, po shënojnë rënie.

Ka tre burime të tjera me të cilat familjet sigurojnë të ardhurat: nga prodhimet bujqesore në fshat; të hollat që dërgon diaspora shqiptare nga jashtë; dhe qeraja që paguajnë zyrtarët ndërkombëtarë. Në zonat rurale, kur nuk ka të holla, fshatarët i kthehen jetës së ekonomisë së mbyllur, duke prodhuar çdo gjë vetë, e duke jetuar jashtë ekonomisë që vepron mbi bazën e parasë.

Sidoqoftë, Mitrovica Jugore ka një komunitet të madh urban. Për këtë shtresë, rënia e mëtejshme e nivelit të të ardhurave do ta shtonte dukshëm varfërinë dhe do të linte vetëm një shteg shpëtimi: emigracionin.

Tabela 6: Mitrovica Jugore: Burimet e të ardhurave në para 2003

Burimi i të ardhurave	Nr. i individëve	Të ardhurat mujore (€)	% e totalit
Spektori privat	5,400	1,074,000	42.6
SOE-të	969	145,350	5.8
Punët me ndërkombëtarët	450	233,550	9.3
Puna në sektorin publik employment (Buxheti i Kosovës)	4,004	699,676	27.8
Pensionet, asistenca sociale (Buxheti i Kosovës)	8,090	368,027	14.6
Të ardhurat totale		2,521,203	100.0

3. MITROVICA E VERIUT DHE FLUSKA E SUBVENCIONEVE

Përlllogaritjet tona tregojnë se të ardhurat mujore në veri të Mitrovicës janë në nivelin €102 për person – dy herë e gjysmë më të lartë se në jug. Megjithatë, pasqyra ekonomike e veriut është edhe më e zymtë se ajo e jugut. Sektori privat është i vogël dhe i pafuqishëm, dhe ish SOE-të janë thujse të gjitha pa punë. Më pak se 2,000 vetë i sigurojnë të ardhurat në sektorin ekonomik, që gjeneron vetëm 15% të të ardhurave të përgjithshme të bashkësisë locale.

Veriu mbahet thujse krejtësisht me subvencione të jashtme, si nga Beogradi ashtu edhe nga Prishtina. Nëse do të ndërpritej qoftë edhe një nga këto burime, pasojat mbi ekonominë lokale do të ishin dramatike.

Buxheti serb mban 4,100 punonjës, shumë prej të cilëve marrin një shtesë në rrogë (*kosovski dodatak*), si dhe u jep ndihmë sociale 2,400 vetëve. Kjo përbën më shumë se 60% të të ardhurave totale në të holla. Por, banorët e veriut, kanë filluar të varen shumë edhe mbi të ardhurat që u jep buxheti i Kosovës, që mbulon 22% të të ardhurave. Në fakt, për frymë të popullsisë Veriu kryesisht serb duket se merr më shumë fonde nga buxheti i Kosovës se sa Jugu. Kjo ka pasojat të dukshme politike për këtë qytet të ndarë.

Kur ecën nëpër rrugët e Mitrovicës Veriore sot, nuk kanë mbetur shumë shenja që të tregojnë se dikur ajo ishte një qendër krenare industriale në socializëm. Përgjatë rrugëve kryesore *King Peter*, *Knjaza Milosa* and *Lole Ribara*, trotualet janë të mbushura me kioska të vogla, ndërsa fermerët nga fshatrat e Zveçanit dhe Zubin Potokut shesin prodhimet e tyre të pakta nga makinat e parkuara dyshe në anë të rrugës. Duke tregtuar pa liçensë, këta mikro-tregtarë janë tipari më i dallueshëm i një ekonomie post-industriale.

300 kioskat përbëjnë shumë më tepër se gjysma e numrit të bizneseve private në Veri. Pjesa tjetër përbëhet nga rreth 160 dyqane Brenda ndërtesave dhe rreth 50 kafene, bare dhe restorante fast-food. Në këtë pjesë ka edhe 5 hotele te vogla, 2 internet café, dhe një numër i vogël kompanish ndërtimi dhe zejtarë si, mekanikë, marangozë dhe hidraulikë. Në total, në vlerësojmë se në rastin më të mirë, sektori privat në Mitrovicën Veriore dhe në Zveçan siguron 1,600 vende pune.

Tabela 7: Mitrovica e Veriut dhe Zveçani: Burimet e të ardhurave në Tetor 2003

Burimi i të Ardhurave	Numri i individëve	Totali i të ardhurave mujore (€)	% e totalit
Sektori Ekonomik			
Punësimi në sektorin privat	1,600	208,000	8.4
Punësimi SOE	302	36,240	1.5
Punë nga komuniteti ndërkombëtar	215	111,585	4.5
<i>Totali</i>		<i>355,825</i>	<i>14.3</i>
Buxheti i Kosovës			
Punësimi publik	1,767	276,075	11.1
Pensione, asistencë sociale & Pagesa nga Trepça (stipende)	7,171	267,232	10.8
<i>Totali</i>		<i>543,307</i>	<i>21.9</i>
Buxheti Serb			
Punësimi publik	4,105	1,391,450	56.0
Transferta sociale	2,396	193,280	7.8
<i>Totali</i>		<i>1,584,730</i>	<i>63.8</i>
Totali i të ardhurave		2,483,862	100

Në Mitrovicën e Veriut prodhohet shumë pak. Në një dokument të hartuar nga Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë renditen 22 “kompani prodhuese”, por këtu përfshihen 10 furra të vogla buke dhe ëmbëltore, 3 dyqane kasapësh, 2 njësi për bërje çelësash dhe 2 marangozë. Në kuptimin e prodhimit të vërtetë, ka vetëm një kompani përpunimi metalesh me 34 punonjës që dikur ka qenë SOE dhe një ndërmarrje e vogël tekstilësh me 9 punonjës. Sektori i shërbimeve është jashtëzakonisht i vogël dhe përbëhet nga disa avokatë, berberë, mekanikë automjetesh dhe lavazhe. Së fundi, por jo me më pak rëndësi, është një grup taksish të parregullta, që qarkullon udhëtarët mes Mitrovicës së Veriut dhe Zveçanit për një gjysëm Euro.

Në Zveçan, pamja është shumë e ngjashme. Të njëjtat kioska dhe taksi gjenden në rrugët kryesore, ndërsa shtëpitë e minatorëve shkrimtarja britanike e udhëtimeve, Rebecca West, i admironte në vitet ‘30-të, po prishen nga mosmirëmbajtja. Me ndihmën e USAID-it, në Doljane, katër kilometra nga Zveçani është ngritur një zonë e re biznesi. Aty janë investuar

mbi €250,000 dhe janë rehabilituar njëmbëdhjetë ndërtesa, por momentalisht janë në përdorim vetëm pesë prej tyre, dy nga një kompani që bën dyer e dritare dhe tri të tjerat nga “Danish Production School”, që zhvillon kurse për aftësimin e njerëzve për bërje çelësash, marangozë, tekstilistë, kuzhinierë dhe teknikë për Teknologjinë Informativë, IT.

Spektori SOE është braktisur thuasjse plotësisht. Trepça, kompleksi minerar masiv rreth së cilit u pat ndërtuar Mitrovica dhe Zveçani, praktikisht ka pushuar së funksionuari. Në Mitrovicën e Veriut dhe Zveçan, rreth 600 vetë janë akoma në borderotë e Trepçës, ndërsa 1,300 të tjerë marrin një pagesë mujore prej €35. Megjithatë, kompania e mbytur në borxhe dhe praktikisht nuk prodhon asgjë dhe pagat dhe pagesat janë subvencione të drejtpërdrehta nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Edhe SOE-të e tjera, shumë prej të cilave tradicionalisht janë varur nga kompleksi i Trepçës, kanë rënë në mënyrë drastike. Ndoshta asnjë qendër tjetër industriale e ish-Jugosllavisë nuk ka pësuar rënie më të rëndë se Mitrovica. Në një ekonomi industriale socialiste që në vitin 1986,¹⁰ siguronte mbi 19,000 vende, vetëm 1,300 punonjës vazhdojnë të marrin rroga, prej të cilëve vetëm 280 janë në Veri. Vetëm katër ish-kompani socialiste vazhdojnë të funksionojnë në Veri : “Kosmet Prevoz”, pasuesja “serbe” e “Kosovotrans”, që kryen shërbime autobusësh për në Serbi dhe në linjat e brendshme lokale; “Minel Enim”, një kompani ndërtimi me qendër në Beograd; “Auto Moto Drustvo”, organizata e automobilëve si dhe një pasues i improvizuar i “Mlinpek”, furra industriale e bukës. Pjesa veriore e kompanisë tregtare “Lux” akoma mban 98 punonjës në bordero, por gati asnjë prej tyre nuk merr rrogë.¹¹

1,900 vendet e punës që kanë arritur të mbijetojnë duhet t’i shërbejnë një popullsie prej 22,000 vetësh. Sikur të jetonin vetëm me ekonominë e vet lokale, Mitrovica e Veriut dhe Zveçani do të renditeshin ndër pjesët më të varfra të një rajoni të varfër.

Megjithatë, ne vlerësojmë se të ardhurat mujore monetare *për frymë* janë mbi €102. 220 punonjës marrin paga të shkëlqyera nga organizatat ndërkombëtare. Ajo që është më e rëndësishme, është se akoma ekzistojnë 1,767 vende pune në sektorin publik të cilat financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, përfshirë këtu mësuesit, punonjësit e komunës, policët, zjarrfikësit dhe punëtorët e subvencionuar të Trepçës. 7,171 të tjerëve u vijnë para nga Prishtina në formën e pensioneve dhe asistencës sociale. Shpenzimet totale mujore të institucioneve të Kosovës për paga dhe transfertat e mësipërme shkojnë deri në mbi gjysëm milion euro. Kjo i kalon shumë të ardhurat e krijuara nga aktiviteti ekonomik lokal.

Përveç kësaj, faktorin më të rëndësishëm ekonomik në Veri e përbëjnë transferet nga buxheti serb. Në shëndetësi ka 1,460 punonjës, 815 në arsimin e lartë, 649 në arsimin fillor dhe të mesëm, 630 të tjerë janë në ndërmarrjet komunale dhe ato të shërbimeve publike “kombëtare”. Së bashku me degët lokale të ministrive serbe dhe institucioneve të tjera, arrijmë në një shifër totale 4,100 pagash të financuara nga buxheti serb. Veç këtyre, rreth 1,300 vetë në Mitrovicë marrin pension serb dhe vlerësohet që në Zveçan këtë pension e marrin 750 vetë. Ka nja 350 persona që nga buxheti serb marrin asistencë sociale. Në total, vlerësohet se çdo muaj €1.6 milion hyjnë në Mitrovicën e Veriut dhe Zveçan nga Serbia në formën e transfertave dhe pagave për sektorin publik.

Përveç kësaj, shumica e punonjësve të institucioneve serbe marrin një “shtesë për Kosovën” (*kosovski dodatak*), e prezantuar nga Millosheviçi pas luftës si një nxitje që serbët të

¹⁰ SAP Kosovw, Pokrajinski zavod za statistiku, “Kosovo u brojkama”, Prishtinë, 1987 (të dhëna nga 30 Shtator 1986).

¹¹ Burimi: Okrug, intervista të ndryshme.

mbeteshin në Kosovë. Akti ligjor i futjes në fuqi të kësaj shtese kishte formën e një “rekomandimi” të qeverisë serbe dhe nuk del të jetë botuar në gazetën zyrtare të Serbisë. Kjo shpjegon edhe arsyen pse kjo masë nuk është zbatuar në mënyrë të rregullt – jo të gjithë zyrtarët e merrnin këtë shtesë, ndërkohë që për ata që e merrnin, ajo ndryshonte nga 40-100% të rrogës së tyre bazë.

Si rezultat, shumica e puntorëve në shërbimin civil në Mitrovicën e Veriut janë shume me mire te paguar se sa koleget e tyre shqiptarë ose puntorët e shërbimit publik ne Sërbi. Mjeku në Mitrovicë në spital fiton, duke ia llogaritur edhe shtesën ditore dhe shtesën e Kosovës, nja 5-600 Euro, kurse pozitat më të larta deri në €1000. Mjekët në spitalin e Kralevës në Sërbinë qëndrore janë te paguar përgjysmë. Rroga mesatare e një mësuesi shkolle është €290, duke u shtuar edhe nga UNMIK-u për nja €150-160, te cilat ne total I afrohen €450, nëse krahasojmë me mësuesit në Kralevë te cilët vështire se i bëjnë €150.

Spektori administrativ në Mitrovicën Veriore dhe Zveçan është më i madh se e gjitha administrata socialiste e Mitrovicës në vitin 1978¹², e cila në atë kohë i shërbente një popullsie prej 105,000 banorësh. Ndërsa Mitrovica Veriore ka një numër të mjaftueshëm nëpunësish të administratës shtetërore, niveli i shërbimeve publike që ata sigurojnë nuk përputhet me shpenzimet.

Në vitet '90-të spitali i Mitrovicës i shërbente një zone të gjerë të Kosovës dhe Serbisë fqinje me një personel prej vetëm 670 vetësh.¹³ Sot, një personel prej 1,100 punonjësish i shërben një popullsie prej vetëm 50-60,000 banorësh:¹⁴ një raport prej 1:54, krahasuar me 1:291 në pjesën tjetër të Kosovës.¹⁵ Universiteti i Mitrovicës Veriore me 1,056 punonjës ka të njëjtin buxhet (10.1 milionë euro) si edhe Universiteti i Prishtinës, që ka 2,500 punonjës¹⁶

Fondet, si nga buxheti i Serbisë edhe nga buxheti i konsoliduar për Kosovën, shpenzohen pothuajse tërësisht për konsum, rroga dhe transferta. i vetmi investim i qenësishëm kohët e fundit është bërë në Universitet (ish-Universiteti i Prishtinës), i cili përpara luftës dhe përpara se të vendosej në Mitrovicën Veriore, me emrin “Universiteti i Mitrovicës”, funksiononte në mërgim në Sërbi. Pesë prej 10 fakulteteve të këtij universiteti janë vendosur në Mitrovicën e Veriut. Gjatë 18 muajve të fundit, janë ndërtuar dy ndërtesa një-katëshe ku strehohen rektorati dhe fakulteti filozofik. Përveç kësaj ka pasur investime edhe në fjetinat e studentëve dhe strehimin e profesorëve.

Pavarësisht varësisë së ndjeshme nga shpenzimet publike, serbët e Mitrovicës nuk kontribuojnë pothuajse me asgjë për buxhetin e Kosovës ose të Serbisë. Për shkak të mungesës së ndonjë agjencie ekzekutive, në vitin 1999 dhe 2002 nuk u mbledhën taksa, kontribute të sigurimeve shoqërore, tarifa studimi apo pagesa për shërbimet publike. Në mesin e vitit 2002 Telekom i Serbisë e lidhi Mitrovicën Veriore me sistemin serb dhe filloi të dërgonte fatura për shërbimet telefonike, por ritmet e mbledhjes së taksave të tjera dhe pagesave për shërbimet publike,

¹² Nw 1978 institucionet administrative në Mitrovicë (që atëherë pëcfshinin edhe Zveçanin dhe Zubin Potokun) punësonin gjithësej 3,854 vetë; shih : Product of Kosova: Business Economic – Propagandistic Guide, Prishtina, n.y. faqet 133-134

¹³ Intervistë me Dr. Marko Jaksic, 28 gusht 2002

¹⁴ Kjo është një vlerësim i përafërt i popullsisë së komunave “serbe” në Veri të Kosovës.

¹⁵ Qeveria e re e Kosovës, *Buxheti për vitin 2002*, faqe 88 (shifra për vitin 2002). Në fillim të vitit 2002 Universiteti i Prishtinës kishte rreth 1,800 të punësuar, por buxheti i vitit 2002 parashikonte një rritje prej 750 punonjësish. Kini parasysh që punonjësit e Universitetit të Mitrovicës punojnë jo vetëm në Mitrovicë dhe Zveçan por edhe në Leposavic dhe Zubin Potok.

¹⁶ Georg /oerber,” Status Report on the University of Mitrovica, Kosovo”, Shkurt 2003, faqe 16. Buxheti i Universitetit të Mitrovicës Veriore, i dhënë nga Republika e Serbisë.

mbeten në një nivel të dobët. Ekonomia e Mitrovicës Veriore dhe e Zveçanit është një flluskë që mund të shpërthejë në ç do moment.

4. NJË E ARDHME JO E SIGURTË

Mitrovica dhe Zveçani po përballen me një të ardhme tejet të zymtë. Rrënimi i kompleksit të Trepçes dhe i sektorit industrial në pronësi shoqërore që u ngrit rreth tij, kanë shkaktuar një rënie ekonomike drastike që nuk është përjetuar ndonjëherë në Europën Juglindore.

Spektori i ri privat përfshin bizneset e vogla familjare të cilat operojnë në një nivel sa për të mbijetuar. Nuk po bëhet ndonjë investim i qenësishëm, as publik dhe as privat në asnjërin prej komuniteteve. Nuk ka asnjë shenjë që tregon se sektori privat po krijon produkte të reja ose po ndryshon orientimin e tij primitiv në drejtim të tregtisë dhe shërbimeve. Me pak fjalë, nuk po ndodh kurrfarë zhvillimi.

Të dy komunitetet varen në mënyrë të ndjeshme nga subvencionet publike dhe prania e vazhdueshme e bashkësisë ndërkombëtare. Veriu varet si nga buxheti i Serbisë edhe nga ai i Kosovës, dhe në fakt përfiton prej mbështetjes nga Prishtina që është në nivele më të larta për frymë sesa për Jugun. Nga ana tjetër, jugu përfiton nga dërgesat e diasporës, e cila siguron një mbështetje të qenësishme, por deri diku, jo shumë të rregullt, për të ardhurat e familjeve.

Nëse detyrohen të mbështeten tërësisht në bazën e tyre ekonomike, të dy komunitetet do të përballëshin me vështirësi reale dhe me mundësinë e një eksodi të përmasave të mëdha të popullsisë. Pra, të dy komunitetet janë tejet të ekspozuar ndaj ndryshimeve në ambjentin politik, të cilat mund të ndikojnë në nivelin e subvencioneve nga një a më shumë burime. Në të dyja rastet sfida e tyre më urgjente është që të gjejnë rrugë për të konvertuar mbështetjen nga jashtë në një zhvillim real përpara se kjo mundësi të humbasë.